

Gjilani ka përjetuar edhe një ngjarje tjetër tragjike. Mbrëmë në Durrës është mbytur B.Selmani, nxënës i klasës XII në gjimnazin “Zenel Hajdini” në Gjilan.

Mbytjen e nxënësit, siç transmeton rajonipress, e ka konfirmuar Nazmi Musa, drejtor i Arsimit në Gjilan. Musa tha se sipas informatave të para, nxënësi B.Selmani, është zgjuar nga gjumi dhe ka rënë nga kati i pestë ku edhe ka banuar.

“Më kanë thënë se ata në Durrës kanë intervenuar me kohë. Unë në emrin tim i shprehi ngushëllimet më të thella sepse vërtet është një rast që na ka prekur e tronditur thellë”, tha Musa.

Të gjithë nxënësit e gjimnazit “Zenel Hajdini” që janë nisur të shtunën në ekskursion për në Durrës pritet të kthehen sot në Gjilan, së bashku me viktimën.